

PERSHKRIM I PERMBLEDHUR I PROJEKTIT

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Shoqata Green Home në Malin e Zi, në partneritet me Forumin Ndërkufitar të Liqenit të Shkodrës në Shqipëri dhe në Malin e Zi, janë duke zbatuar projektin: “Të mbështesim propozimin e Rezervës së Biosferës Ndërkufitare të zonës së Liqenit të Shkodrës, nëpërmjet metodave të pjesëmarrjes”. Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian në kuadër të programit IPA Ndërkufitar Shqipëri-Mal i Zi.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në mbrojtjen e biodiversitetit të zonës nëpërmjet inkurajimit të aktiviteteve të përbashkëta ndërkufitare të zhvillimit në kontekstin e mbrojtjes së mjedisit.

Projekti do të bazohet mbi metodologjinë e UNESCO-s (Man and Biosphere), “Njeriu dhe Biosfera“ i cili përshat mbrojtjen e ekosistemeve në përputhje me zhvillimin social kulturor të zonës.

Në kuadër të këtij projekti do të ngrihen kapacitetet e Shoqërisë Civile dhe pushtetit vendor mbi rezervatin e biosferës, teknikat e advokimit për mbrojtjen e Liqenit të Shkodrës, standartet e EU për Biodiversitetin si dhe përfaqësues me programin “Njeriu dhe Biosfera”.

Për zbatimin e projektit do të ngrihet Grupi i Punës i përfaqësuar nga OJF-të lokale në rrethin e Shkodrës, të cilët do të jenë edhe aktorët kryesorë të projektit. Ky grup pune do të ndjekë nga afër dhe do të japë kontributin e tij teknik për çdo fazë të projektit, si edhe do të vazhdojë punën që do të nisë projekti edhe në përfundim të tij.

Në kuadër të projektit, do të përgatitet një manual trajnimi i cili do të ketë disa module, dhe do të vihet në dispozicion të gjitha NGO-ve mjedisore dhe pushtetit vendor në Shkodër. Në përfundim të tij projekti do të sjellë edhe një studim mbi “Rezervatin e Biosferës në zonën e Liqenit të Shkodrës.”

Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij projekti janë listuar si më poshtë vijon:

Aktiviteti 1: Ngritja e Grupit të punës me përfaqësues të NGO-ve mjedisore të zonës së projektit bazuar mbi disa kritere të qarta selektimi;

Grupi i Punës do të ketë një strukturë të thjeshtë. Përzgjedhja e anëtarëve të grupit të punës do të bëhet mbi bazën e disa kritereve. Disa nga përgjegjësit kryesorë të grupit të punës do të jenë:

- Të ndjekë dhe të komentojë teknikisht të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- Të vazhdojë punën e nisur në kuadër të këtij projekti edhe kur projekti të ketë përfunduar, veçanërisht nga struktura ndërkufitare të tilla si Forum ndërkufitar i Liqenit të Shkodrës.
- Do të kontribuojë me kapacitetet njerëzore ekzistuese për realizimin e ekspertizës që pritet të ketë projekti.
- Për menaxhimin sa më të mirë dhe transparent të projektit, do të krijohet një Komitet drejtues. Anëtarësimi në këtë komitet Drejtues, do të jetë me përfaqësues nga të dy vendet.

- Një ekspertizë nga Zyra e UNESCO-s në Venecia, do të sigurojë asistencën teknike për projektin mbi çështje specifike në lidhje me rezervën e Biosferës.

Aktiviteti 2: Organizimi i një seminari Inagurues për projektin sëbashku me NGO-të e përzgjedhura;

Një takim inaugurues për projektin do të organizohet për të formalizuar edhe krijimin e grupit të punës. Përfaqësuesit e NGO-ve të përzgjedhura do të mblidhen së bashku për të rënë dakort mbi aktivitetet e projektit dhe rezultatet e pritshme. Takimi do të fokusohet në informimin dhe bashkëpunimin gjithëpërfshirës me NGO-të mjedisore dhe aktorë të tjerë vendorë në qytetin e Shkodrës. Një aktivitet vizibiliteti (Konferencë shtypi) do të organizohet me këtë rast, për të informuar publikun e gjërë për aktivitetet e projektit dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar.

Aktiviteti 3: Hartimi i një studimi specifik për rezervën e biosferës së Liqenit të Shkodrës;

Studimi do të marrë parasysh të dhënat ekzistuese dhe të nxjerra nga punime të tjera si ato të projektit të BB (2005,) por do të ripunojë keto të dhëna duke bërë analiza të thelluara dhe duke përcaktuar edhe rrugët e zgjidhjes.

Aktiviteti 4: Përgatitja e Manualit Trajnues në të dy gjuhët;

Manual i trajnimit do të jetë gati përpara fillimit të trajnimit dhe do të përfshijë, por jo vetëm:

- ✓ Njohuri të përgjithshme mbi programin “Njeriu dhe Biosfera” metodologjia, (moduli i trajnimeve)
- ✓ Kohën dhe programin ditor,
- ✓ Grupet e Interesit,
- ✓ Mjetet e monitorimit dhe vlerësimit,
- ✓ Shëmbuj,
- ✓ etj.

Aktiviteti 5: Përgatitja dhe organizimi i 2 kurseve të trajnimit, një shkëmbim informacioni dhe eksperience, një seminar teknik (secili 3 ditë) me të paktën 25 pjesëmarrës.

Në kuadër të këtij aktiviteti do të organizohet një seminar teknik tre ditor. Pjesëmarrësit në këtë kurs trajnimi do të jenë anëtarë të OJF-ve të përzgjedhura (pjesë e Grupit të Punës) si edhe përfaqësues të autoriteteve rajonale dhe Kombëtare sidomos nga Administrata e Zonave të Mbrojtura.

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit do të vlerësohen për njohuritë e fituara në kuadër të këtij trajnimi. Seminari do të jetë edhe një mundësi për të identifikuar nevojat për ngritje kapacitetesh të tilla si (ekspert, paisje apo metodologji), të cilat mund të merren në konsideratë në një fazë të dytë eventuale të projektit në fjalë.

Një aktivitet vizibiliteti (Konferencë Shtypi) do të organizohet përgjatë sesioneve të trajnimit për të informuar publikun në lidhje me programin Njeriu dhe Biosfera dhe mjetet për ngritjen e kapaciteteve.

Aktiviteti 6: Dizajnimi i nje sistemi monitorimi për të vlerësuar impaktin e aktiviteteve për ngirtjen e kapaciteteve

Në kuadër të këtij aktiviteti mbi bazën e modeleve ekzistuese do të ngrihet një skemë monitorimi për të vlerësuar impaktin e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve sipas objektivave të këtij projekti. Kjo skemë monitorimi që do të përdoret në këtë projekt, mund të përdoret në të ardhmen për të monitoruar aktivitete të tjera të ngritjes së kapaciteteve.